

Dalës-Izlazës

Nr. -1-355 Data 23.12.2020
Br. _____ Datum _____

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴³, mbledhja e 13) me dt. 30.12.2020 (e mërkurë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E


1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara:
 - a) Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e dt.30.11.2020 dhe
 - b) Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e dt.11.12.2020
3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal për vitin 2021
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri

Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.11.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena, (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkryetar i Komunës, për komunitete, drejtorët komunal, përf.e Qendrës rinore.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishikimi i Planit të Veprimit për Rekomandimet e ZKA-së dhe Lista e rreziqeve
4. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës, për formimin e Ndërmarrjes publike lokale "Kastrioti"
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi – Ju e dini se kolegu ynë Muhamet Mustafa, ka ndërruar jetë dhe tash e kemi anëtarin e radhës nga AAK-ja, z.Lulzim Bllaca të cilin e ftoj që ta japë betimin solemn.

Lulzim Bllaca – Dha betimin solemn sipas rregullës për anëtar të Kuvendit komunal.

Kryesuesi – Injoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aziz Bici – Unë e kam një propozim për pikën e 4 të rendit të ditës. Ne si LVV, në parim jemi që gjithsesi e mbështesim listën përkrijimineNdërmarrjes publike "Kastrioti" por kërkojmë nga kryesuesi që vendimin për votimin e kësaj Ndërmarrjeje ta shtyj për seancën e radhës, në mënyrë që ne anëtarët e Kuvendit komunal, të kemi më shumë informacione që lidhen me ndihmën e funksionimit të saj. Ne duhet ta kemi të qartë se kur planifikohet të filloj me punën secili sektor i saj, sa është kostoja totale për themelimin e kësaj Ndërmarrjeje, numrin total të punëtorëve që do të punësoj kjo Ndërmarrje sipas sektoreve dhe afateve kohore.Pra, mënyrën e organizimit, organigramin e ndërmarrjes përveç pozitave drejtuese, që sipas ligjit në fuqi emërohen nga Bordi i drejtorëve, sa më shkurt derisa të sjelletpër formimin e Ndërmarrjes publike "Kastrioti"duhet ta kemi edhe planin e biznesit të saj. Prandaj kërkoj të na sjellin në formën e shkruar në mbledhjen e radhës në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë lidhur me këtë Ndërmarrje.

Kryesuesi – Sqaron se është akti i themelimit të kësaj Ndërmarrje publike, pastaj Ndërmarrja do të ketë Statutin e vet, përcaktimin e organigramit dhe gjërave tjera. Pra, së pari duhet akti i themelimit, kalojnë procedurat ligjore nëpër Ministri, pastaj vjen drafti fillestar për shqyrtim publik, del në debat publik dhe vjen për votim. Kjo, siç po shihet kërkon kohë një vit apo një vit e gjysmë sepse procedurat zgjatin. Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për dhe me 2 vota abstenim e miratuan rendin e ditës të cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal, janë të pranishëm në mbledhje.

Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Vlen të theksohet se raporti për vitin 2019, ka qenë një ndër raportet më të mira sa i përket Zyres kombëtare të auditimit sepse ishte raport pa asnjë rekomandim të theksimit të çështjeve. Tani, për një sqarim më detal, fjalën ia japë drejtoreshës së financave.

Zarife Behluli – Ju edini se ne i kemi pasë 7 rekomandime, 5 prej tyre kanë qenë të plotësuara në fillim të vitit dhe 2 pjesërisht të plotësuara. Sa i përket menaxhimit të rreziqeve, ne jemi të obliguar këtë me dërgue në Ministri, do të thotë janë formularët të cilët i plotësojnë që janë shabllon nga Ministria e financave. Të gjitha Drejtoritë komunale dhe Prokurimi e kanë plotësuar listën e rreziqeve se çka hasin ata në problemet gjatë kryerjes së punëve të tyre. Psh, sa i përket ligjit është rrezik i lartë, strukturimi brenda Drejtorive është rrezik i mesëm, financiar është rrezik i lartë, kapacitetet e burimeve njerëzore janë rrezik i mesëm, strategjik është rrezik i lartë, Komitetet si obligim i brendshëm është i lartë dhe punëtorët e brendshëm janë rrezik i mesëm. Këto, të gjitha ne i zbatojmë.

Aziz Bici – Sipas ligjit nr.04/I-042, të Prokurimit publik, neni 28, pika 10 thotë se përcakton përgatitjen e specifikimeve teknike për kontrata të punës. Autoriteti i kontratës është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutiv dhe nuk i lejohet të lëshoj dokumentacionin e tenderit pa e bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Do të thotë se këtu, është lidhur kontrata pa projekt dhe unë fjalën e kam te rekomandimet numër 5, te investimet kapitale, ku thotë se për kontraktimin e një kompanie që të bëjë hartimin e projekteve ekzekutive, të ceket edhe se është përmbushur gjatë periudhës mars-qershor. Ne kërkojmë emrin e kompanisë së kontraktuar dhe punët që ajo ka bërë deri më sot. Gjithashtu, e kërkojmë nga një kopje të këtyre të dhënave të iu dërgohet secilit anëtarë të Kuvendit komunal, në mënyrë fizike ose përmes emailit.

Kryesuesi – Të gjitha kontratat janë publike dhe në raportet e Zyres së Prokurimit, gjegjësisht në raportet e Kryetarit të Komunës, në raportet 6 mujore dhe vjetore. Të gjitha këto janë publike në web faqen e Komunës.

Zarife Behluli – Sqaron se fjala ka qenë për një rrugë të shkurtë dhe për me mbrojtë buxhetin, atë rrugë e kanë hartuar arkitektët tonë. Auditorët kanë dhënë vërejtje se çdo projekt që hartohet duhet me qenë në kontraktimet projektuese dhe kjo për vitin 2020 është e plotësuar. Pra, e vetmja ka qenë mbrojtja e buxhetit.

Kryesuesi – Atëherë, drejtoreshë për mbledhjen e radhës mbetet që në bashkëpunim me shefin e Zyres së Prokurimit të iu ktheni përgjegje me shkrim.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën e Kryetarit të Komunës, për formimin e Ndërmarrjes publike lokale "Kastrioti".

Fatos Kurshumlija – Ne si grup jemi për themelimin e kësaj Ndërmarrjeje publike lokale "Kastrioti", por kisha dashur që të përfshihet edhe mirëmbajtja e komplekseve banesore.

Kryesuesi – Shton se kjo çështje veç është e përfshirë.

Aziz Bici – Prapë po them se ne jemi gjithsesi që të themelohet një Ndërmarrje e tillë sepse Komuna jonë, ka nevojë sidomos për shkak të krijimit të parqeve dhe zonave të gjelbërta, kemi nevojë për mirëmbajtje. Mendoj se shumë gjëra sot duhet të sqarohen psh në Komunën tonë, ne e kemi edhe kompaninë "Pastrimi"

dhe asetet që posedon Komuna në bazë të aksioneve të kompanisë "Pastrimi", a do të kalojnë në kuadër të Ndërmarrjes "Kastrioti", apo si do të jetë kjo çështje.

Kryesuesi – Jo, ajo do të vazhdoj punën.

Aziz Bici - Ne nuk kemi informacione të mjaftueshme për me ditë se çka po ndodhë. Në rast se ne sot e votojmë dhe në të ardhmen na dalin telashe, unë mendoj se nuk ia vlen voto ç' voto.

Nazmi Gashi– Për pikën e rendit të ditës, për të cilën po bisedojmë unë kam thënë edhe më heret sepse po përfundojnë investimet kapitale në Komunën tonë dhe vjen radha e mirëmbajtjes së asaj që e kemi punue. Psh, në elektroekonomi në KEK, ndërtimtaria ka qenë si njësi shërbyese dhe më shumë krijojmë të hyra ne si njësi brenda KEK-ut, se investitorët e punëtorët e jashtëm që i merrnim e që na kushtonin shumë më shtrenjtë. Mendoj se është shumë e logjikshme, praktike dhe e pranueshme, që është dashur me qenë shumë më heret, por uroj të jetë me fat dhe të ia shohim hajrin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht e aprovuan Vendimin për formimin e Ndërmarrjes publike lokale "Kastrioti".

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga shoqata sindikale e administratës komunale për pagesën e shujtës ditore në vlerën prej 2.5 €, për të gjithë punëtorët e administratës komunale. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kjo kërkesë iu ka rekomandue Drejtorisë së përgjithshme të administratës dhe Zyrës ligjore për sqarim ligjor. Ne kemi marrë përgjegje nga Drejtoria e administratës, se kjo kërkesë duhet të shqyrtohet në Kuvend, pasi që i nënshtrohet ligjshmërisë së MPL-së. Tani e hapi diskutimin për këtë çështje.

Enver Gashi – Ne si grup i AAK-së, jemi për aprovim të kërkesës në fjalë, të sqarohet ana ligjore dhe nëse, kemi mjete buxhetore të ndahen 2.5 €. Punëtorët e administratës komunale këtë e meritojnë sepse kanë një punë bukur voluminoze.

Lulzim Sadiku–Sa i përket kërkesës së sindikatës, ne e kemi bërë një analizë dhe jemi pro kësaj kërkesë. Në emër të grupit të PDK-së, ne kërkojmë që kjo vlerë 2.5 €, të bëhet 3 €, sepse 2.5 €, është vlerë e vogël dhe punëtorët e administratës punojnë nën stres, me ngarkesa si dhe me probleme të ndryshme.

Fatos Kurshumlija – Edhe ne e përkrahim këtë kërkesë, nëse na lejon ligji.

Aziz Bici – Edhe ne si grup i LVV-së, e përkrahim këtë shumë të mjeteve dhe sigurisht se sindikata e ka pasur parasysh se a është 2.5 €, apo 3 €. Prandaj, ne e mbështesim kërkesën e sindikatës për ndarjen e mjeteve prej 2.5 €, për shujtë.

Armend Rushiti– Ne si LB, e përkrahim këtë kërkesë të kësaj shoqate dhe jemi pro këtij vendimi, normal duke respektue ligjin dhe procedurat tjera.

Slavisa Spasic – Unë e mbështes z.Lulzim Sadiku, që të ndahen 3 € për shujtë të punëtorëve.

Nazmi Gashi – Unë derisa jam pensionue kam punue edhe në prodhim dhe në administratë dhe punëtorët e prodhimit vërtetë e kanë hallall, ndërsa punëtorët e administratës me hy dhe me i kontrollue është mjaft problem. Mendoj se nuk është çmimi 2.5 €, por a është hallall, apo nuk është hallall sepse dikush nuk e meriton as në shtëpi me ngrënë, e le më këtu. Mirëpo është mirë me ua dhënë këtë vlerë të mjeteve.

Ibush Mjekiqi – Unë si Nënkryetar Komune, këto ditë kam qenë në detyrë për Kryetarin sepse Kryetari është i izoluar dhe besoj se brenda 2,3 dite do të jetë këtu. Ne jemi marrë me këtë kërkesë dhe vullneti i Kryetarit dhe i qeverisjes tonë është që këtyre punëtorëve të iu jepet shujta. Ju e dini se është një shtesë prej vitit 2016, që nuk precizohet për çka është, prandaj ne jemi pro kësaj kërkesë, por natyrisht që kjo të shqyrtohet në MPL, nëse ka bazë ligjore. Po ashtu, duhet të precizohet se kjo shujtë do të realizohet nga 1 janari i vitit 2020.

Kryesuesi – Kërkesa e sindikatës ishte për 2.5 €, z.Lulzim propozoi 3 €, por zakonisht ne shkojmë në votim sipas kërkesës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimisht morën Vendim për aprovimin e kërkesës nga Shoqata sindikale e administratës komunale për ndarjen e mjeteve në vlerën prej 2.5 €, për shujtë ditore të punëtorëve të administratës komunale.

Kryesuesi – Paraqet rekomandimin nr.4, të KPF-së, për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës. **Anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht morën Vendim për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.**

Pika e 6 e rendit të ditës

Aziz Bici– Unë në pikën "Të ndryshme" i kam 2 çështje me i ngritë. Përgjatë këtyre ditëve si rezultat i uljes së temperaturave, unë si asambleistë i Komunës së Obiliqit kam zhvilluar disa vizita nëpër shkolla në nivele të ndryshme gjithandej Komunës, për të parë nga afër gjendjen e këtyre institucioneve, ku ndër të tjera është vërejtë mungesa e mjeteve higjienike si dezinfektues, gjithashtu, edhe mungesë e lëndëve djegëse për ngrohje. Në disa prej këtyre shkollave vizitat e mia nuk kanë qenë të mundshme për shkak të një vendimi të pashkruar që më pamundëson hyrjen në shkollë. Pas kërkesës time ndaj drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, z. Zeka, që të kam leje për të realizuar vizitat e këtilla ai më tha se diçka e tillë nuk është në asnjë formë e mundshme për shkak të vendimit të Qeverisë. Prandaj, unë kërkoja një kopje të një dokumenti që përcakton këtë vendim, ku me gjithë premtimin se do të ma përcjellin në email, ata nuk më kanë dërguar asnjë email, ku definohet se si i ndalohet hyrja në institucionet publike një përfaqësuesi të qytetarëve, një asambleisti. Prandaj, unë kërkoj sqarim sot se si ka mundësi një vendim i marrë nga Qeveria, të ia pamundëson asambleistit vizitat nëpër institucionet publike dhe të mos i jepet asambleistit paraprakisht. Unë e kam një çështje tjetër lidhur me fshatin Milloshevë, kryesisht stadiumi i cili shfrytëzohet nga 2 klube futbollit, klubi futbollistik "Liria" dhe klubi futbollistik "Ardhmëria". Klubi futbollistik "Liria" e shfrytëzon xhveshtoren te objekti i ambullantës të mjekësisë familjare, ndërsa klubit futbollistik "Ardhmëria" nuk i jepet e drejta për me shfrytëzue. Unë kërkoj nga Drejtoria përkatëse, që të ia mundëson edhe këtij klubi derisa Kuvendi komunal, e njeh edhe këtë sepse është subvencionue njejtë sikurse ai.

Lulzim Sadiku – Unë dola me bë një kërkesë që do ta arsyetojmë si Kuvend komunal, njëkohësisht edhe si qytetarë dhe kërkojmë shërim për të gjithë ata që kanë pasë problem me Covid 19, dhe unë për vete nuk e kam ditë që e kam pasë Covidin, e kam kalue me shpresë se nuk do të kem më telashe. Unë e kam një kërkesë dhe në kuadër të asaj kërkesë do ta kërkoj edhe votën borxh që po thojnë sepse ndoshta, iu vyen edhe vota jonë. Unë kam një kërkesë e cila duhet të jetë e përgjithshme për qytetarët e Komunës tonë. Në Komunën tonë nga Covid 19, janë të vdekur gjithsej 19, ose 21 dhe kur them 19, ose 21 për shkak se 2 të cilët janë shërue dhe po thojnë se kanë vdekur në spitalin e Mitrovicës së veriut, nuk i kemi të dhënat e sakta. Kërkoj që këtyre familjarëve si Kuvend komunal, si subvencion të iu ndajmë një shumë të mjeteve prej 500 €, secilit familjar. Nëse, janë 19, iu bjen 9,500 €, që nuk është shumë e madhe dhe iu ndihmon shumë. Neve, na ka vdekur kolegu që na ka mërzit të gjithëve, jemi ndier keq dhe sot besoj se do ta ngritim dorën bashkarisht në mënyrë që të iu ndihmojmë këtyre familjeve. Pra si kërkesë dua të hudhet në votim që të iu ndihmojmë familjeve me rastin e vdekjes së anëtarit të tyre me një shumë prej 500 €.

Fatos Kurshumlja– Unë dua të ndërlihem me atë që tha z.Lulzim dhe me vazhdue me kërkesën time. Mendoj se jo vetëm ata që kanë vdekur, por nëse e bëjmë atëherë duhet me vazhdue edhe uroj të mos ketë të tjerë. Kërkesa ime është për fshatin Lajthishtë, drejtuar drejtorit të shërbimeve publike, besoj se ai është përgjegjës sepse uji po rrjedhë aty afër një vit. Së paku afër 5 herë është thirrë ujësjellësi dhe bashkëfshatarët e mi afër 20-30 herë kanë ardhë, jam takuar edhe me një përgjegjës këtyre ditëve, që ma bëri pak bajat kërkesën që ua bëra. Unë kisha dashur që aty me ndërhye sa më parë sepse uji është duke e marrë tërë rrugën e pishave, do të thotë rrugën tonë. Mirëpo, tash dimrit temperaturat kanë rënë në minus, është duke u ngrit aty dhe kisha dashur që sa më parë me bë një ndërhyrje, do të thotë rruga kryesore që lëshohet te fshati para se me shkue te bunari, si të përfundojnë shitoret.

Nazmi Gashi– Kur e kemi dhënë betimin e kam shprehë një dëshirë me marrë një mirënjohje Kuvendi ynë, sa i përket anëtarëve të Kuvendit komunal. Unë kam pritë më shumë edhe prej vetes dhe prej juve. E uroj aktivitetin e anëtarit të LVV-së, për rastet e kontrollit nëpër shkolla dhe nëpër lagje. Për herë të parë tash kam nisë edhe me ndryshue pak se ua uroj një fitore brilante, që e kanë bërë në Podujevë. Unë nuk e kam

ndërmend me u marrë me politikë sepse e përfundoj me këtë mandat, por ne duhet me qenë më aktiv me qytetarët dhe në vitin e ardhshëm duhet me dhënë maksimumin, që me u prekë problemet. Mendoj se ka probleme të mëdha, ka kërkesa të mëdha dhe ne nuk kemi bërë punë të mjaftueshme. Ne e kemi edhe një vit, që duhet të bashkohemi dhe të japim përfundimisht rezultate të mira dhe ta marrim atë mirënjohje që ua kemi premtue, që besoj se pajtohet edhe kryesuesi sepse na takon.

Dragan Dancetovic - Unë edhe më parë i jam drejtuar Kuvendit në këtë foltore dhe problemi është për një rrugë në Baimoc. Kjo, është një rrugë fushore, që është e regjistruar në kadastrë, por rrugë e cila nuk i plotëson kushtet që të jetë rrugë me dimensione të mundësisë së shfrytëzimit. Këtë rrugë praktikisht e shfrytëzojnë 10 familje dhe e kanë të pamundur që në mënyrë adekuate të arrijnë deri te arat e tyre. Prandaj, edhe njëherë po iu drejtorhem dhe drejtori i kadastrit është i njoftuar për këtë problem, në mënyrë që të zgjidhet ky problem sepse janë në pyetje 10 familje dhe 7-8 hektarë të tokës së punueshme.

Kryesuesi – Kjo kërkesë ka ardhë në muajin e kaluar që e kemi shqyrtuar në KPF, dhe ia kemi rekomanduar Drejtorisë përkatëse. Mirëpo, për shkak të numrit të madh me Covid 19, të punëtorëve të Drejtorisë edhe ka mbetë kjo kërkesë. Gjithsesi, duhet me bë një zgjidhje sepse sipas kërkesës ato toka janë të gjitha të komuniteteve.

Ibush Mjekiqi – I përgjegjem z.Fatos Kurshumlja se DSHPE-ja, do të shikoj që ajo çështje sa më shpejt që është e mundur të realizohet përmes ujësjellësit. Sa i përket rrugës në Baimoc, ne e dijmë se e kemi rregullue në vitin e kaluar një rrugë të re, deri në Baimoc e cila komplet ka qenë rrugë e arave dhe është krijuar një mundësi atje. Mirëpo, jo vetëm kjo rrugë por edhe për rrugë të tjera, do të mundohemi ti realizojmë dhe ne jemi në faza të realizimit të infrastrukturës rrugore, për lagje të të gjitha vendbanimeve në Komunën e Obiliqit. Mendoj se më prioritet është çështja e rregullimit të infrastrukturës rrugore duke siguruar qasjen në rrugë cilësore, por sido që të jetë edhe kjo çështje do të shqyrtohet në Drejtorinë përkatëse. Tani te çështja e z.Lulzim Sadiku, është e vërtetë se në Komunën tonë janë 20 të vdekur dhe ne e dijmë se jemi në fund të vitit, por kjo kërkesë mbetet aktive se si do të jetë situata në të ardhmen. Ju njoftoj se në Komunën tonë deri më tani janë testuar 1,062 individë dhe prej tyre 536 kanë qenë pozitiv. Deri në kohën që tani po flasim 383 janë të shëruar, 135 i kemi aktiv me shifrat e sotme dhe 20 të vdekur. Meqenëse, jemi në fund të vitit, mendoj se vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore, duhet ta marrim në vitin tjetër. Sipas informatave Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, ka fillue me i shpërnda vaksinat e gripit sezonal dhe ne posa të furnizohemi me vaksina që nga nesër do të fillojmë me vaksinim. Sa i përket çështjes së shfrytëzimit të fushës në Milloshevë, bashkë me Drejtorinë e kulturës z. Aziz, e them me përgjegjësi të plotë se që një vit e gjysmë jemi duke u përballur me këtë problem. Duke parë se kanë pasë probleme të 2 klubet, ne kemi ndërhy në vitin e kaluar dhe në këtë vit është nxjerrë Rregullorja për dhënien në shfrytëzim të fushave sportive. Ne iu kemi ofruar marrëveshje klubeve dhe klubi me të cilin ke pasë kontakt ka refuzue nënshkrimin e marrëveshjes. Në këtë formë, mendoj se ai është duke e shfrytëzuar në mënyrë ilegale, që ka ndodhë edhe në vitin e kaluar përmes Drejtorisë së inspektoriatit dhe policisë janë vënë shiritat për ndalimin e shfrytëzimit të kësaj për shkak të problemeve, që kanë pasë. Është një problematikë e cila është afër zgjidhjes, por klubi me të cilin ke bisedue është problematik, sidomos personi dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë. Sa i përket çështjes së xhveshtoreve, aty xhveshtore nuk ka, por është objekti i vjetër i ambulancës, të ish Qendrës së mjekësisë familjare dhe klubi "Ardhmëria" e ka një kontejner aty, të cilin e kemi lejue në vitin 2015, kështu që atij nga ana jonë iu ka lejue edhe shpenzimi i ujit dhe rrymës. Tash, ai është duke e shfrytëzue, por marrëveshjen për shfrytëzim nuk e ka bërë. Sa i përket vizitave në shkolla dhe mungesës së mjeteve higjienike, unë them me përgjegjësi të plotë se mjete higjienike ka të mjaftueshme dhe janë vendet e posaçme ku janë ato. Te çështja e vizitave nëpër shkolla në këtë kohë të pandemisë, por edhe pa pandemi jo vetëm ju por edhe Kryetari i Komunës, nuk mund të hyj çdo herë dhe kurdo sepse duhet me paralajmëruar, ka një rregullë se pa paralajmërim nuk mund të hyhet. Mendoj se përmes Kuvendit, mund ta formoni një Komision që ti vizitoni të gjitha objektet arsimore, shëndetësore dhe objektet tjera, pastaj të vini me konstatim, por jo në mënyrë individuale. Shkollat natyrisht se do të jenë të

hapura për vizitat e anëtarëve të Kuvendit, por në mënyrë të paralajmëruar, përmes Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së shkollave, gjithmonë do të jeni të mirëseardhur.

Kryesuesi – Meqenëse, kërkesa për ndihmë familjeve me Covid 19, ka impakt buxhetor, jemi në fund të vitit dhe propozoj që ta shtyejmë në mbledhjen e radhës. Kjo, nga fakti se familjet mund të presin shumë muaj derisa të iu dalin mjetet dhe mendoj se duhet të iu ndihmojmë personave të prekur me Covid 19, nga se shërimi i tyre po kushton shumë. Ne do të takohemi në bashkëpunim me shefat e grupeve dhe me Kryetarin, do ta diskutojmë këtë çështje dhe do ta zgjidhim këtë problem.

Aziz Bici – Prapë, po flas lidhur me këto 2 klubet futbollistike. Në rast se ky klub nuk e ka nënshkruar marrëveshjen, atëherë edhe unë ju them mos i lejoni me shfrytëzue, as hapsësirën e fushës së sportit, as objektin e ambullantës të mjekësisë familjare. Unë këtë informatë nuk e kam, por do të takohem prapë me ata. Në kuadër të këtij klubi është edhe ekipi i vajzave dhe mua më kanë tregue se është një kontejnerë, por nuk i plotëson kushtet. Prandaj ju them në rast se atanuk i marrin përgjegjësitë sipas Rregullores që është e nxjerrë prej Komunës, atëherë mos lëshoni pe. Unë kam edhe informacione, që sot dua me i përdorë se ai objekt është duke u përdorë jo për diçka të keqe, por ndoshta diçka jashtë asaj lidhur me sportin, ndonjë lojë playstation. Sa i përket vizitave që i kam bërë në shkollë, është mirë Nënkyetar që herave të tjera, kur të thuash me u bazue në ligj, mos me thënë ke, apo nuk ke të drejtë sepse kjo ke dhe s'ke të drejtë, ma merr mendja se është çka them unë dhe çka thua ti. Unë i kam vizitue disa shkolla në Mazgitin e Epërm, Mazgitin e Poshtëm, Krushëfc, Palaj, Lajthishtë, Sibofc, Hade, ndërsa gjimnazin nuk kam mund me vizitue për shkak se thashë, që është thënë se është një vendim në fuqi i Qeverisë, që nuk kemi të drejtë. Asnjë problem nuk e kam pasë me asnjë drejtor në përgjithësi dhe nuk kam shkue me thënë ti zë keq, por kam shkue për shkak të shqetësimeve që i kam, që mos të na bëhet vonë deri nesër, për shkak të kësaj pandemie. Për fat të mirë shumicës së shkollave, iu kanë mbetë lëndë djegëse prej vitit të kaluar dhe ka shkolla që nuk kanë lëndë djegëse hiç. Në fshatin Mazgit i Epërm, që aty ka fillue problemi, aty shkolla sivjet është rritë dhe janë bërë 2 anekse, në të dy anët e shkollës. Unë e kam parasysh se ka vonesa, përveç se kam kërkuar që mos të thuhet se kemi nxemje, por nxemja që gjendet në klasë të ketë kapacitetin e duhur që vërtetë, fëmijët mos të kenë të ftoftë. Është thënë se duhet me pasë leje dhe kam kërkuar leje, është thënë s'ka leje, por është vendimi në fuqi. Unë prapë po them, vetëm atë kopje të vendimit në fuqi ma jepni sepse unë nuk jam i interesuar juve, me iu thënë se nuk e respektoj vendimin. Nëse, nuk më pëlqen ai vendim dhe mendoj se është i jashtëligjshëm, atëherë sigurisht se janë rrugët tjera, për me kontestue vendimin e Qeverisë. Mirëpo, me i thënë një asambleisti se nuk ke të drejtë me shkue së paku nëpër koridorin e shkollës dhe në asnjë shkollë nuk kam kërkuar me hy në klasë përveç në Mazgitin e Epërm sepse kur u futa në koridor e pashë, që e morën sepse në sallë të arsimitarëve nuk ka nxemje. Unë sa e kam parë nxemja ka kapacitet 3 kilovat, qysh janë me 3 tela dhe ju e dini se tash janë duke u ulë temperaturat dhe ju e dini se ato gjatë natës nuk guxon me i lënë sepse ato janë të rrezikshme. Nxemjen e kanë marrë nga salla e arsimitarëve dhe e kanë futë në klasën e parashkollorëve. Unë asgjë tjetër nuk kam bërë vetëm e kam fotografue atë nxemje, jo nxënësat dhe askend tjetër. Unë jam interesue me ditë në cilën klasë se ajo ishte klasë më e vogël, ndërsa në klasët tjera, kam trokit si gjithmonë që troket prindi, ose asambleisti. Unë kam trokit në derë, kam hy brenda, i kam përshëndet, e kam shikue atë nxemje dhe i kam pyet a keni të ftoftë, apo jo. Kjo është e tëra, prandaj prapë po them në rast se mua nuk ma jepni vendimin, atëherë ju nuk e kryeni detyrën e institucionit dhe kjo kalon në personale, që në rastet personale mua më duhet me i përdorë mekanizmat tjerë, me i njoftue edhe qytetarët se çka doni ju që nuk e lejoni asambleistin. Mendoj se në rast se i respekton masat mbrojtëse të Institutit të mjekësisë, duhet me pasë të drejtë së paku deri aty. Prapë, po them se material të higjienës ka, por fjala është për dezinfektues dhe janë të furnizuar me material higjienik, por edhe materiali dezinfektues i takon asaj çështjeje.

Kryesuesi – Ne në mbledhjen e KPF-së e kemi pyet drejtorine Arsimit, i cili na ka tregue se me keqardhje lënda është në Zyren e Prokurimit, sepse çështja e druve është centralizue. Mirëpo fati që e kemi menaxhue se nuk kanë mbajtë mësim afër 6 muaj, prandaj edhe ne jemi shqetësue prej janarit sepse edhe ne i kemi fëmijët nëpër shkolla. Sa i përket menaxhimit me dezinfektues ka qenë në nivel, por edhe në KPF është

trajtime çështja pse nuk ka nxemje në disa shkolla e në disa shkolla ka nxemje. Sinqerisht centralizimi, mbledhja e drunjve në nivel të regjionit po na shkakton telashe, që është e padrejtë ndaj fëmijëve, mirëpo uroj që sa më shpejt të përfundon projekti i nxemjes qëndrore që është nisë. Anëtarët e Kuvendit kanë qasje në institucionet publike, por me leje të Drejtorisë së Arsimit dhe drejtorit të shkollës.

Ibush Mjekiqi – Çështja e furnizimit me lëndë ngrohëse për shkollat është vështirësue, sidomos prej kohës kur është marrë vendimi për ndalimin e përdorimit të thëngjillit nëpër shkolla. Prej se është mbyllë shkolla prej 13 marsi të këtij viti, Drejtoria e Arsimit vazhdimisht ka bërë përpjekje që të siguroj lëndë djegëse dhe e ka kryer pjesën procedurale. Në organin e shqyrtimit të Prokurimit publik, është lënda e cila merrë kohë për shqyrtim dhe kështu kemi ardhë deri në këtë situatë. Unë besoj se brenda kësaj jave, do të bëhet zgjedhja e operatorit sepse po të ishte në nivelin komunal, atëherë do të ishte pak më shpejtë. Fatmirësisht ne kemi rezerva edhe për disa ditë dhe besoj se drutë do të vijnë së shpejti. Unë nuk thashë se anëtarët e Kuvendit komunal, nuk kanë të drejtë me hy në shkolla, por duhet përmes një lajmërimi dhe absolutisht të drejtën e ka secili, lajmërohet te Drejtoria përkatëse. Unë jam shumë mirë i informuar se ka sasi të mjaftueshme të materialit dezinfektues dhe këtë e them me përgjegjësi të plotë. Tash, nuk e di se a je shkue në rolin e anëtarit të Kuvendit, apo inspektorit, s'po e kuptoj dhe nëse nuk ke shkue në rolin e anëtarit të Kuvendit, është dashur me ngritë padi ndaj atyre që s'kanë pasë material dezinfektues. Sinqerisht, nuk jam duke të kuptuar.

Aziz Bici– Unë me shkue në rolin e inspektorit, nuk është në natyrën time dhe e di se më parë kisha dalë në rrjetet sociale. Unë po them se ka qe 10 ditë, apo 2 javë që kam fillue vizitat e para nëpër shkolla dhe as nuk më ka shkuar mendja askund. Unë po them në shkollën në Mazgitin e Epërm, ditën e parë nuk ka pasë, ndërsa në shkollat tjera ka pasë. Në shkollën gjimnazi "17 Shkurti" në çdo kat dera kur futesh të përplasë, janë të mbyllura dhe mundesh me marrë kontakt vetëm me punëtorin për mirëmbajtje. Poshtë, në hyrje të objektit është një tavolinë me një shishe të plastikës, që e kam të fotografuar vetëm 2 cm poshtë dhe nuk është funksionale. Nxemjet që janë radiatorët nuk ka fare, se nuk kam parë dhe aty, nuk kanë ngrohje. Pasi, po thua unë nuk shkoj, me shkue si inspektor ai shikon qysh me shkruie dhe unë nuk kam shkue qysh me shkruie. Mua, në momentin kur më është ndalue, prapë kam vizita dhe së paku nuk më është dhënë një kopje e vendimit dhe vetëm ma jepni atë kopje, atëherë është në rregullë. Ju, këndeje më akuzoni si inspektor dhe kam shkue kur më keni thënë jo, sepse unë po të doja prapë po e përsërisë isha dalë në rrjetet sociale menjëherë. Unë nuk kam shkue aty, me luftue me ata, por me bashkëpunue sepse mos harroni se deri nesër ky Covid, mund të marrë ende jetë njerëzish më shumë dhe mos thoni deri nesër se nuk keni qenë bashkëpunues. Është mirë përgjegjësi me marrë bashkë, ejo me refuzue qysh jeni duke e refuzue duke u munduar mua me më vendosë herë andej, e herë këndeje. Unë nuk shkoj në rolin e inspektorit dhe nuk jam me thënë vetëm të shkoj e të bëjë keq, keq dhe po iu them këtë merreni seriozisht.

Kryesuesi – Ne jemi në një fazë, ku të gjithë duhet të bëhemi bashkë për me luftue një dukuri, e cila po na përcjellë, por edhe gripi sezonal e ka bërë të veten dhe njerëzit po kanë simptome të ndryshme. Mirëpo, e di se vullneti nuk ka mungue dhe ku punohet edhe ka mundësi me gabue. Ju lus, Nënkrjetar për të tjerat nëse; i keni dokumentet ia jepni asambleistit atë që po kërkon.

Lulzim Sadiku– Unë e përgëzoj Z. Bici, që e ka bërë këtë vizitë sepse vërtetë ka bërë një punë të mirë. Mendoj se duhet me tu lejue, nuk ka mundësi me ta ndalue askush, nuk duhet me pengue procesin dhe nuk besoj se një anëtar i Kuvendit komunal, e pengon procesin. Ju njoftoj se në fshatin Sibofc, brenda 2 jave kanë ndodhë 5 vjedhje. Komuna e Obiliqit, i ka vendosë kamerat dhe ne jemi gëzue sepse ku ka siguri, ka edhe jetë. Unë nuk po bëjë politikë, por kërkoj që të merren masa sepse regjioni matanë Qyqavice, është në telashe me çështjen e hajnisë. Unë po nisem prej një ferme në fshatin Sibofc, një kushëri i imi me emrin Agron, i cili ka një sasi mbi 40 krerë lopësh, ka pasë problem para 3 netësh dhe as policia nuk kanë shkue në vendin e ngjarjes. Kërkoj në mënyrë kolegjiale dhe shoqërore të merren masa nga komandanti i policisë, me kërkue pse po ndodhin gjithë këto hajni dhe nuk ka asnjë kapje.

Ibush Mjekiqi – Në mbledhjen e Këshillit për siguri që e udhëheqë Kryetari, unë isha herën e fundit dhe kjo dukuri është shqetësuese. Mendoj se jo në mënyrë shoqërore, por institucionale duhet me i bërë të gjitha

veprimet në mënyrë që qytetarët të kenë siguri. Prandaj, faleminderit për kontributin e dhënë, jemi të gjithë këtu, për këtë punë dhe do të bashkëpunojmë me organet e sigurisë për sigurimin e qytetarëve tonë.

Kryesuesi – Sa i përket kamerave, Drejtorja nuk guxon me mbulue pjesën më të madhe me digjitalizim të kamerave, në rrugën kryesore po, por jo edhe lagjeve. Është një e mirë se pjesa më e madhe e rrugëve, fshatrave dhe lagjeve janë të mbuluara me ndriçim publik. Ju e dini se tash jemi me pandemi, kemi papunësi të madhe, njerëzit janë larguar nga puna, jetojnë me stres dhe kam thënë se ky vit është vit i mbijetesës. Unë e di se policia është duke u marrë me këtë çështje, sinqerisht më vjen keq, për rastin që ka ndodhë dhe uroj që të merren masa nga stacioni i policisë sa më shpejtë.

Kryesuesi – Shtojë o Aziz.

Aziz Bici – Shtojë o Aziz, kështu po thotë kryesuesi, dhe për mua e vërtetë nuk është çkado, por ne të gjithë duhet të shqetësohemi për këtë punë. Mendoj se këtu, nuk është në pyetje se është Covidi, nuk është në pyetje se është papunësia, por është në pyetje diçka tjetër, mos bashkëpunimi i organeve në përgjithësi me qytetarët, sidomos i policisë. Për mua, e shtroj pyetjen dhe ende nuk kam marrë përgjegje, as ndaj vetes, as ndaj kolegëve, as ndaj askujt. Prandaj, në cilat raste qytetari ynë e ka vullnetin dhe besimin me lajmëruar rastin në polici dhe ai që e ka, kisha pasë dëshirë me më tregue. Unë për vete sinqerisht po them ende nuk e di. Kjo është besueshmëria e policisë në Komunën tonë. Andaj, Këshilli për siguri mos të jepë raport koti me thënë veç te mbajmë, por le të i ofron të gjitha informacionet që janë të nevojshme për neve, si asambleistë dhe ata duhet me i ditë se cilat janë. Këto, janë të nevojshme për qytetarët, ta kthejnë besimin e qytetarit për me dhënë informacionin sepse kur e kemi informacionin dhe bashkëpunimin me qytetarët jam i bindur se kjo sigurisht se nuk ndalet asnjëherë krejtë. Mirëpo jo, aq shumë me u vjedhë në Komunën tonë, që është rrezik të rritet vjedhja edhe më shumë nganjëherë, vjedhja mund të shkojë edhe më në rrezik, të humben edhe jetë njerëzish, duke u munduar qytetarët me mbrojtë pasurinë e vet.

Kryesuesi – Unë nuk u shpreha ashtu, por herave tjera, do ta ruaj raportin vetëm zyrtar dhe do të respektohet Rregullorja e punës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri





Dalës-Izlazja

Nr. - 1-354

Data 23.12.2020

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.11.12.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë:Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena,(AAK),Enver Gashi (AAK), FlorijeJashari (AAK),Qendresa Dubova (AAK), Lulzim Bllaca (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlja (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK),Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB),Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës,Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për komunitete, drejtorët komunal, Haki Jashari, drejtor i QKMF-sëdhe përf.e Qendrës rinore.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Ndarja e mjeteve financiare për ndihmë banorëve të prekur nga pandemia Covid-19.

Kryesuesi–Fillimisht konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 20 anëtarë të Kuvendit komunal, mungon vetëm anëtarja Xhezide Dragusha (LVV). Ne para se ta thirim këtë seancë të jashtëzakonshme kemi pasur një takim me Kyetarin e Komunës, shefat e grupeve dhe përfaqësuesit e partive politike në Kuvend, kështu që ne jemi dakorduar për fondin dhe mënyrën e shpërndarjes së mjeteve për këtë çështje. Ne e kemi kërkesën e Kryetarit të Komunës, duke parë situatën e rëndë të shkaktuar nga Covid 19, për banorët e Komunës tonë, për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme për ndarjen e mjeteve për banorët e prekur nga Covid 19.Tani, e hudhi rendin e ditës në votim.

Miratohet unanimisht rendi i ditës i cekur më lartë.

Kryesuesi- Fillimisht fjalën ia dha Kryetarit të Komunës.

Kryetari– Duke parë seçdo ditësituatapo përkeqësohet në drejtim të pandemisë dhe duke parë mundësinë buxhetore që e kemi nga DSHPE-ja, janë mjetet nga të hyrat vetanake që mund ti shfrytëzojmë, ne bashkë me shefat e grupeve parlamentare që ishim në takim bashkëbiseduam për këtë çështje. Ne nxorrëm një konkluzion të përbashkët për të gjithë ata që janë të prekur nga Covidi 19, të ndahen nga 100 €, ndërsa për të gjithë ata që kanë pësuar një vdekje të ndahen nga 300 €..Ne kemi menduar që të ndahen 90,000 €, i kemi 700 raste dhe shpresojmë se për këtë vit janë të mjaftueshme. Po ashtu, kemi menduar që ky vendim të vazhdon mëtutje deri në mbylljen e pandemisësë. Shpresoj se edhe në tëardhmen do të kemi mundësi që në linjat e ndryshme të subvencionimit për ndarjen buxhetore për ti mbështetë deri në përmbylljen e pandemisë nga IKSHP-ja, ose nga OBSH-ja.

Enver Gashi–Ne si grup i Aleancës, kemi marrë pjesë në takimin e parë me shefat e grupeve parlamentare ku jemi dakorduar plotësisht për ndarjen e mjeteve, 100 €, për të prekurit me Covid 19 dhe 300 €, për rastet

e vdekjeve. Uroj që të përfundojnë këto dhe të mos kemi më asnjë rast të vdekjeve dhe ne si Aleancë e përkrahim plotësisht.

Lulzim Sadiku—Vërtetë, në takimin me Kryetarin, kryesuesin dhe me shefat e grupeve parlamentare, ne e kemi analizuar dhe vlerësuar situatën drejtë dhe jemi pro kësaj që e tha Kryetari. Ne i kemi analizuar të gjitha mënyrat se qysh mund të veprojmë edhe në të ardhmen, ndërsa ajo që është e dmosdoshme në këtë ditë është se duhet të iu ndihmohet njerëzve sado pak lidhur me këtë sëmundje, që e kanë. Unë si shef grupi, e kam marrë mbështetjen e PDK-së, dega në Obiliq dhe mendoj se ky vendim është vërtetë i mirëseardhur. Pra, ne jemi pro kërkesës.

Fatos Kurshumlija —Së pari kërkoj falje se ne atë ditë jemi informue shumë vonë për mbledhjen e grupeve me Kryetarin, që kanë qenë. Ne si grup jemi pro kësaj kërkesë, porkisha dashur me shtjellue se njerëzit që kanë bërë teste në laboratorët private, a do të iu ndihmojmë këtyre njerëzve, do të thotë se njerëzit që bëjnë teste serologjike që e kanë kaluar covidin, a ju takon kjo pjesë.

Aziz Bici— Edhe ne kemi marrë pjesë në takimin e 7 dhjetorit me Kryetarin dhe me përfaqësuesit e partive politike të Kuvendit komunal. Ne e përkrahim shumë e mjeteve prej 100 €, për banorët të cilët kanë qenë të prekur nga covid dhe 300 €, për familjet që kanë humbur të afërmin e tyre. Mendoj se ne duhet të iu përmbahemi kriterëve, kemi diskutuar së bashku dhe janë të gjithë ata që përfshihen në listën e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Njëherit, kërkoj nga Ekzekutivi që të iu përmbahet këtyre kriterëve.

Armend Rushiti- Ne nuk kemi marrë pjesë në atë takim për shkak të obligimeve në punë. Ne e përkrahim këtë iniciativë, por propozoj mundësisht ata që janë aktiv dhe nuk kanë mundësi të lëvizin nga shtëpia me i mbështetë edhe me ndonjë pako ushqimore, në mënyrë që të mos dalin dhe ti infektojnë të tjerët.

Dragan Dancetovic— Srpska lista podrzava predlog koji je gradonacelnik izveo u ovoj sednici Skupstini Opstine. Zato ova odluka koju cemo verovatno doneti, a to je odluka sakojom Skupstina Opstine, pomaze svojim ugrozenim gradjanima u vreme ove pandemije. Parafolësi i mëparshëm e bëri një pyetje rreth testeve në laboratorët private sepse ka ente të ndryshme të cilat lëshojnë dokumente të ndryshme zyrtare dhe këto duhet të jenë të pranueshme. Kjo ndihmë duhet të iu jepet qytetarëve që jetojnë në territorin e Komunës së Obiliqit, të cilët nuk janë të kursyer nga pandemia dhe kjo shumë simbolike do të jetë e mirëseardhur për ata. Në këtë drejtim gjithësesi duhet të iu ndihmojmë dhe të iu japim përkrahje. Dua, të them se njëpjesë e komunitetit pakicë në Komunën e Obiliqit, testimet i bëjnë në Shtëpinë e shëndetit në Prelluzhë, ku kryhen teste relevante dhe propozoj që këto teste të pranohen ngaky ent shëndetësor.

Nazmi Gashi —Është mirë që Kryetari po merr pjesë në mbledhje dhe ne tash jemi duke biseduar për këto raste, që vërtetë janë të detyrueshme të nevojshme për qytetarë. Propozoj për pensionerët dhe për ata të cilëve më heret iu kemi mbetë borxh mundësisht me gjetë një formë dhe me i rehatue sepse kjo pandemi e ka prekë ekonominë dhe familjet, që është një telashe e madhe. Mirëpo, shpresojmë se nuk do të zgjatë shumë dhe ne është mirë që të heqim dorë nga disa projekte, që këta 3,4 muaj të bëhemi më zemërgjerë me iu ndihmue njerëzve në nevojë. Shpresoj se pas kësaj me ndërhyrjen e Komunës, ne do ti ofrohem i shpëtimit.

Kryetari — Ne diskutuam atë ditë për listat që janë në IKSHPK dhe këtu u potencuan testet që janë edhe për komunitetin serbë. Unë sa e di, pjesa më e madhe e institucioneve që merren me testimin e Covidit, e kanë një lidhmëri me Institutin kombëtar sepse kur po na vijnë listat se ku e kanë bërë testin po kanë shifra të ndryshme, se cilat janë të Institutit kombëtar dhe cilat nuk janë. Mbi të gjitha, ju jeni ata që e vlerësoni se kjo është për të gjithë të prekurit me Covid, por mund ta bëjmë secili që e ka dëshminë. Nëse, ndonjë institucion privat nuk është i regjistruar në listat e Institutit kombëtar të shëndetësisë, është mirë me ia krijue mundësinë edhe atyre, nëse e kanë dëshminë.

Kryesuesi — Unë e falenderoj shtabin në krye me Kryetarin për menaxhimin e pandemisë si dhe drejtorin e QKMF-së, për angazhimin e tij maksimal në këtë gjendje të jashtëzakonshme. Ju e dini se pikërisht për shkak të Covidit, sot kolegju ynë Muhamet Mustafa, nuk gjendet më në mesin tonë sepse virusi po vret.

Mendoj se kjo ndihmë sipas mundësisë buxhetore, do të jetë simbolike dhe kjo është e mirëseardhur për menaxhimin sado pak të kuletës familjare të familjeve të prekur me këtë sëmundje.

Kryetari – Ne aktualisht të hyrat vetanake i kemi 112,000 €, dhe nëse ka nevojë që të plotësohet kjo shifër, do të thotë nëse dalin më shumë kërkesa, ne mundemi me plotësue.

Fatos Kurshumlija – Pyetise a mund tëiu ndihmojmë persovave që i kanë bërë testet serologjike dhe të cilët kanë dalë se e kanë përfunduar Covidin.

Kryetari – Përgjegjet nëse, nuk është i evdientuar se është me ovid, atëherë vlerësone vetë.

Shaip Paloja– Unë e përshëndes këtë iniciativë të Kryetarit dhe shpresoj se do të kaloj. Mendoj se këtu, duhet të sqarohen shumë gjëra sepse kur jemi te testet private, duhet të dijmë se pjesa më e madhe e laboratoreve e kanë pasë kohën kur është dashur të licencohen nga Ministria e shëndetësisë. Tash, nëse ne i marrim të gjitha labororet që kanë bërë teste nuk janë të licencuara, mendoj se është e padrejtë sepse ato teste mund të mos jenë valide dhe mund të mos jenë të sigurta. Mendoj secili test që është i regjistruar në Institutin kombëtar të shëndetësisë të kompensohet me këtë propozim të Kryetarit, përndryshe nëse fillojmë me laboratore anembanë Kosovës që janë pa licencë, atëherë edhe 500,000, ose 600,000 €, nuk do të dalin.

Haki Jashari–Sa i përket çështjes të cilën e ngriti z.Fatos, me të drejtë duhet ta kemi të qartë se valide janë vetëm raportet që i kadhënë Instituti kombëtar i shëndetësisë. Pra, nuk mund të merren për bazë testet serologjike sepse testet serologjike mund të kenë vlera të larta edhe te disa sëmundje tjera. Çështja tjetër është se çdo laborator që bën testin PCR, duhet ta njoftoj Institutin kombëtar të shëndetësisë, pastaj ato të dhëna nai dërgojnë neve. Mendoj se këtu, duhet të kemi qasje te kriteret, në mënyrë që të mos krijohet paqartësi te qytetarët. Vetëm raporti i Institutit kombëtar të shëndetësisë është valid dhe i pranueshëm.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerën prej 90,000 €, nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, për përkrahjen e banorëve të prekur me Covid-19, për qytetarët e Komunës së Obiliqit (me vendbanim të përhershëm).

Mbledhja përfundoi në ora 10:38'

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri

